



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Janar 2022

Nr: 22

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MAT, ME KANDIDATIN
NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SË REFORMAVE DEMOKRATIKE TË
TË SHQIPËRISË, ZJ. ARENDINA QEMAL GASA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 4789 prot., datë 03.11.2021, këshilli i bashkisë Mat, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Sulltana Ismail Kuka, propozuar nga Partia e Reformave Demokratike të Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë së Reformave Demokratike të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Mat të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 12, zj. Arendina Qemal Gasa.

Me shkresën nr.7128, prot., datë 14.12.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Mat, zj. Arendina Qemal Gasa, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Data: 26 Janar 2022

Nr. 22

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mat, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë së Reformave Demokratike të Shqipërisë zj. Arendina Qemal Gasa

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia e Reformave Demokratike të Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 01 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, zj. Arendina Qemal Gasa, në këshillin e bashkisë Mat, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 15 prot., datë 10.01.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 14 prot., datë 10.01.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, zj. Arendina Qemal Gasa, në këshillin e bashkisë Mat, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 140/1 prot., datë 19.01.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Arendina Qemal Gasa, në këshillin e bashkisë Mat, e cila rezulton se ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, duke e ndryshuar këtë përbërës nga “Çeka” në “Gasa”.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 213/1 prot., datë 17.01.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Arendina Qemal Gasa, në këshillin e bashkisë Mat, e cila rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Arendina Qemal Gasa, në këshillin e bashkisë Mat, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



V E N D O S:

1. Zj. Arendina Qemal Gasa, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Mat, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mat, me kandidatin nga lista shumemërore e partisë së Reformave Demokratike të Shqipërisë, zj. Arendina Qemal Gasa.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 26 Janar 2022

Nr. 22

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mat, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë së Reformave Demokratike të Shqipërisë, zj. Arendina Qemal Gasa